



INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS



QEVERTISJA LOKALE
DHE PJESEMARRJA
QYTETARE



TRANSPAROMETRI KOMUNAL

CILA PREJ KOMUNAVE ËSHTË ME E NXEHTË NË
TRANSPARENCE?

PRILL-SHTATOR 2014.

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

CILA PREJ KOMUNAVE ËSHTË ME E NXEHTË NË TRANSPARENCE? PRILL-SHTATOR 2014.

Copyright © 2014. Kosova Democratic Institute (KDI).

All rights reserved. Except for the quotation of short passages for the purposes of criticism and review, no part of this publication may be reproduced, stored in a retrieval system, or transmitted in any form or any means, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise, without the prior permission of KDI.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
METODOLOGJIA.....	9
RENDITJA E KOMUNAVE	11
TRANSPARENCA NË KOMUNË	13
Transparenca në Gjakovë.....	13
Transparenca në Gjilan	14
Transparenca në Prishtinë	15
Transparenca në Graçanicë	17
Transparenca në Prizren.....	18
Transparenca në Deçan	19
QASJA NË RRJETE SOCIALE.....	21
REKOMANDIMET	23
Reformimi i Menaxhimit të Ueb-faqeve	23
Dokumente Lehtë të Qasshme Online	23
Transparencë Buxhetore për Pjesëmarrje Qytetare	24
Ri-Organizim Institucional për Avancim të Transparencës	24
Komuna e Prishtinës	24
Komuna e Prizrenit	25
Komuna e Gjilanit.....	26
Komuna e Gjakovës.....	26
Komuna e Deçanit	26
Komuna e Grançanicës	27
ANEKSET, INDIKATORËT DHE KOMENTET	29
Aneks 1: Indikatorët dhe Pesha e Tyre	29
Aneks 2: Transparometri komunal (1).....	30
Aneks 3: Transparometri komunal (2).....	31

HYRJE

Niveli i transparencës dhe hapjes së një institucionin ndaj publikut është tregues thelbësor për mënyrën e qeverisjes së atij institucionit nga udhëheqësit, të zgjedhurit. Përpos që mund të qoj në keqpërdorime të pushtetit, niveli i ulët i këtij elementi thelbësor të qeverisjes, transparencës ndaj publikut, shkakton mosinformim të duhur të publikut, ngrit mosinteresimin e publikut në punët publike dhe ulë pjesëmarrjen qytetare, një tjetër element i rëndësishëm për qeverisje të mirë.

Çështjet publike në një sistem demokratik pritet të ndahen me publikun e gjërë, tu ipet hapësirë për shqyrtim dhe diskutim në qarqet e shoqërisë civile dhe të mbesin publike në mënyrë që përgjegjësit të mbahen llogaridhënës për atë që kanë planifikuar, vendosur dhe bërë gjatë udhëheqjes së një posti publik. Në veçanti, qeverisja lokale është tejet e rëndësishme që të jetë e hapur sepse komuna është dera e parë për qytetarë kur kërkojnë shërbime publike bazike. Për më tutje, transparenca në planet komunale, buxhet dhe shpenzime është tejet e rëndësishme edhe për interesim dhe përfshirje qytetare, një element tjetër i një shoqëri evropiane demokratike.

Kosova vazhdimisht është kritikuar dhe ranguar dobët për transparencë institucionale. Këtë vit me të drejtë edhe Raporti i Progresit për Kosovën i hartuar nga Komisioni Evropian thekson se komunat “duhet të vazhdojnë përpjekjet për transparencë në vendime” gjë që tregon se ende nuk ka transparencë të plotë në këtë fushë. I njëjtë raport thekson se “zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është i pamjaftueshëm.” Qasja e lehtë për qytetarë në vendimet e institucionet të tyre publike është vlerë e qeverisjes demokratike dhe evropiane ku synojmë të jemi pjesë. Është thelbësore që qeverisja komunale të bëjë përpjekje të jetë e hapur dhe të ju mundësojë qytetarëve të janë të përfshirë në politika dhe projekte lokale dhe ta mbajnë qeverinë të përgjegjshme.

Nganjëherë tek komunat tona shkak i transparencës së pamjaftueshme, si e quan edhe Raporti i Progresit, është mungesa e resurseve humane në komunë dhe kësaj duhet ti gjendet një zgjidhje jo vetëm nga institucionet lokale por edhe qeveria qendrore. Mirëpo shpesh si shkak i kësaj mos-transparency është pavetëdija e udhëheqësive se si punët publike të janë transparentë dhe lehtë të qasshëm apo ndonjëherë është edhe mos vullneti për të qenë transparent.

Andaj dhe akterë nga shoqëria civile, përfshirë Institutin Demokratik të Kosovës, i kanë dhënë vëmendje të konsiderueshme transparencës institucionale. KDI, krahas monitorimit të institacioneve tjera, që disa vite monitoron dhe vlerëson transparencën në komuna, përpos institacioneve tjera. Ky indeks është përpiluar të shërbej si një mjet, për shoqerinë civile dhe zyrtarët komunal, të matin transparencën e institacioneve lokale. Është shumë me rëndësi që të kemi një sistem të vlerësimit sa më objektiv dhe me indikatorë të matshëm që do të tregojnë gjendjen e qeverisjes në komunë dhe trendet nga viti në vit.

Ky indeks me 44 indikatorë matës të transparencës komunale ka për qëllim të sjell një metodologji të lehtë dhe objektive për matje të transparencës në komuna dhe gatishmërinë e zyrtarëve lokal për të qenë të hapur ndaj publikut dhe gjithëpërfshirës në vendimmarije. Ky indeks mund të shërbejë edhe si mekanizëm për nxitjen e konkurrencës në mes të udhëheqësive të institacioneve që të janë sa më të hapur ndaj publikut dhe të ndihmojë udhëheqësit e komunave me vulnet të mirë të identifikojnë dhe përmirësojnë pikat e dobëta në qeverisje që mund ti kenë. Pra, Transparometri përbën në vete një mekanizëm të krahasimit të transparencës së qeverive lokale të udhëhequra nga subjekte të ndryshme politike. Po ashtu, ky indeks krijon mundësinë që të dallohen komunat me performancë më të mirë nga ato me performance më të dobët në qeverisje dhe të mënjanojë përgjithësimet në vlerësim të

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

komunave që shpesh janë abuzuar nga akterë të ndryshëm.

Njëjtë si përdorim termometrin për të matur temperaturën kur ndihemi të sëmurrë, duhet të përdorim edhe Transparometrin për të matur nivelin e transparencës në institucionet lokale dhe zyrtarët përgjegjës të jenë të hapur për punët publike që iu kanë besuar nga vetë qytetarët-votues.

Ky punim prezanton Transparometrin dhe vlerësimin e gjashtë komunave pilote për periudhën gjashtëmuajore, prill deri në shtator 2014 (tre-mujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2014).

METODOLOGJIA

Vlerësimi i Transparometrit ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. Ky indeks përbëhet nga 44 indikatorë dhe matë transparencën në *Zyrën e Kryetarit/es, Kuvendin Komunal, Financat Komunale* dhe transparencën në *Konsultime me Publikun* (secila nga katër shtyllat përmban nga 11 indikatorë).

Indikatorët janë përgjedhur me kujdes duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat nën qeverisjen lokale që përcaktohen me ligjet në fuqi. Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban.

Para se të fillojë vlerësimi i transparencës komunale me indikatorë, KDI ka ndarë dhe diskutuar në fokus grup me zyrtarët për informim të komunave nën vlerësim (përfaqësuesit e dy nga komunave s'kanë qenë prezantë edhe pse të ftuar).

PESHA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Disa indikatorë normalisht janë më të rëndësishëm për transparencë komunale se disa të tjerë, andaj secili prej 44 indikatorëve iu është caktuar pesha e vetë. Pesha e indikatorëve varion nga 1 deri në 5 në bazë të rëndësisë së indikatorit (shikoni *Aneksin 1* për indikatorët dhe peshën e tyre). Për secilën nga katër shtyllat, pesha maksimale e 11 indikatorëve së bashku është 35.

Ndërsa vlerësimi i secilit indikatorë është bërë me notën 0 deri në 3 (0 është dhënë aty ku komuna s'ka qenë fare transparente, 3 është dhënë në ata indikatorë ku komunat kanë qenë plotësisht transparente, ndërsa 1 dhe 2 janë dhënë për ata indikatorë ku komuna ka qenë pjesërisht transparente). Nota vlerësuese (0-3) është përpjeshëtuar me peshën indikatorit dhe është nxjerrë një vlerësimi i atij indikatorit. Shuma e notave vlerësuese të 11 indikatorëve ka dhënë dhe notën e përgjithshme për komunën në atë shtyllë (Zyre të Kryetarit/es, Kuvend Komunal etj).

Matja e transparencës së indikatorëve është bërë përmes katër mënyrave: ueb-faqes zyrtare të komunës, intervistimit të zyrtarëve komunal (pozitë dhe opozitë), monitorimit të takimeve zyrtare të komunave dhe kërkesave për qasje në dokumente publike.

PËRGJEDHJA E PILOT KOMUNAVE

Një nga qëllimet e Transparometrit është edhe nxitja e konkurrencës për performancë më të mirë në transparencë. Andaj, në vlerësimin e indeksit që do të shpaloset më poshtë janë të përfshira gjashtë (6) komuna pilote që udhëhiqen nga subjekte politike të ndryshme. Janë përgjedhur katër komuna më urbane të Kosovës që udhëhiqen nga subjekte të ndryshme dhe dy komuna me popullsi mesatare pasi udhëhiqen nga subjekte të ndryshme.

Komunat e përfshira si pilot në këtë indeks janë Komuna e Prishtinës, që është komuna më e madhe dhe udhëhiqet për herë të parë nga subjekti i Lëvizjes Vetëvendosje! (LVV), Komuna e Prizrenit si komuna e dytë më e madhe dhe komuna me popullsinë më të madhe që udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Komuna e Gjilanit si një nga shtatë komunat më urbane të Kosovës dhe që udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Komuna e Gjakovës, po ashtu një nga shtatë komunat më urbane, dhe që udhëhiqet për herë të parë nga subjekti Aleanca Kosova e Re

QEVERTISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

(AKR), Komuna e Deçanit pasi është komuna më e madhe që udhëhiqet nga subjekti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Komuna e Graçanicës si komuna me popullsi shumicë të komunitetit serb e udhëhequr nga Lista Qytetare Serbe (GLS).

Duhet përmend që Kuvendet Komunale të Gjakovës dhe Prishtinës udhëhiqen nga subjekte politike ndryshë nga udhëheqësia e Zyrës së Kryetarit/es (që të dyja nga LDK) andaj dhe vlerësimi për Kuvende Komunale në këto dy komuna i atribuohet subjektit që udhëheq kuvendin e jo ekzekutivin e komunës.

RENDITJA E KOMUNAVE

Në përgjithësi transparenca në komuna (këto të përfshira në studim) ka lënë për tu dëshiruar, duke përfshirë këtu disa nga komunat me kryetarë të rinj. Nga 44 indikatorët matës që përbëjnë këtë indeks, kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale, asnje komunë nuk del të jetë 100% transparente. Kjo tregon që edhe komunat me performancën më të mirë në qeverisje kanë ende punë për të bërë që të janë plotësisht transparente, së paku në këto çështje thelbësore të qeverisjes që ky indeks i adreson.

Disa pengesa tek transparenca kommunale shkaktohen nga Ministria për Administratë Publike për shkak se ajo është përgjegjëse për platformën dhe menaxhimin e ueb-faqeve të komunave, gjë që kufizon komunat në përpjekje për të bërë dokumente dhe informata lehtë të qasshme për qytetarët e saj. Ueb-faqet e komunave janë të centralizuara dhe nuk lejojnë hapësirë për modernizim dhe përshtatje të ueb-faqeve për qytetarët nga komunat e tyre përkatëse. Duke pasur parasysh përdorimin e internetit në kohët e sotme, ueb-faqet janë tejet të rëndësishme për institucionet publike të bëjnë informatat dhe dokumentet lehtë të qasshme për publikun.

Përgjegjësia më e madhe për hapje të komunës ndaj qytetarëve i mbetet udhëheqësve lokal dhe administratës lokale. Shpërndarja e informatës për planet, planifikimet buxhetore dhe planifikimet e projekteve mbeten sfida që duhet të adresohen dhe praktikohen nga vëtë udhëheqësit komunal. Gjatë punës tone, shumë herë kemi has në mos gatishmëri për të ndarë informatën, herë për shkak të mos vullnetit, herë për shkak të frikës se zyrtarëve të administratës për të ndarë një informatë publike pa dijen e udhëheqësve politik të komunave.

MAPL gjithashtu mund të bëjë shumë më shumë që rregulloret që i lëshon të zbatohen në nivel komunal. Kjo ministri shpesh anashkalon mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve për komuna. Kurse Asociacion i Komunave mund të bëjmë më shumë në koordinimin e komunave që të adresojnë sfidat me të cilat komunat përballen për të qenë më të hapur ndaj publikut dhe më të qasshëm nga publiku dhe si të ngriten kapacitetet për të qenë më transparent.


Nga 44 indikatorët matës të transparencës që përbëjnë këtë Transparometër (shih metodologjinë për përzgjedhje e indikatorëve dhe *Aneksin 1* për indikatorët dhe peshën e tyre në vlerësim) del se disa ngecje në qeverisje komunat i kanë të përbashkëta dhe kurse disa ngecje që qëndrojnë tek një komunë nuk qëndrojnë tek disa të tjera. Të gjeturat e këtij indeksi tregojnë që performanca në transparencë e komunave dallon dhc përderisa disa komuna janë në rrugë të mirë për të arritur transparencë totale në çështje bazike, disa komuna janë hermetikisht të mbyllura ndaj publikut.

SHTYLLA	PIKË TË MUNDSHME	VLERËSIMI PËR KOMUNË					
		Gjakovë	Gjilan	Prishtinë	Graçanicë	Prizren	Deçan
Ekzekutivi	35.0	28.3	17.0	23.3	9.3	13.7	11.0
Kuvend	35.0	23.0	29.3	17.0	22.0	20.0	24.0
Financa	35.0	27.0	24.3	17.0	16.0	8.3	0.0
Konsultime me publikun	35.0	28.7	22.7	24.3	17.0	10.0	3.3
Mesatarja e Pikëve	18.2	26.8	23.3	20.4	16.1	13.0	9.6
<i>Niveli i Transparencës</i>		76.4%	66.7%	58.3%	46.0%	37.1%	27.4%

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

Në bazë të gjeturave të këtij indeksi me 44 indikatorë në katër fushat bazike të qeverisjes lokale, të matur për periudhën gjashtë mujore (prill-shtator, 2014) del se Komuna e Gjakovës ka qenë komuna me transparente nga gjatë komunat e matura me 76.4% transparente. Pastaj radhiten Komuna e Gjilanit (66.7% transparente), Komuna e Prishtinës (58.3% transparente), Komuna e Graçanicës (46.0% transparente), Komuna e Prizrenit (37.1% transparente) dhe Komuna e Deçanit (27.4% transparente).

NIVELLI TRANSPARENCE S KOMUNALE



Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Zyrës së Kryetarit*/es, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjakovës (28.3 pikë), Komuna e Prishtinës (23.3 pikë), Komuna e Gjilanit (17.0 pikë), Komuna e Prizrenit (13.7 pikë), Komuna e Deçanit (11.0 pikë) dhe në fund, apo më pak transparente, del Komuna e Graçanicës (9.7 pikë).

Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Kuvendit Komunal*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjilanit (29.3 pikë), Komuna e Deçanit (me 24.0 pikë), Komuna e Gjakovës (me 23.0 pikë), Komuna e Graçanicës (22.0 pikë), dhe Komuna e Prizrenit (20.0 pikë) dhe më paku transparente në kuvend komunal del të jetë Komuna e Prishtinës (17.0 pikë).

Radhita e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Financave Komunale*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna e Gjakovës (27.0 pikë), Komuna e Gjilanit (24.3 pikë), Komuna e Prishtinës (17.0 pikë), Komuna e Graçanicës (16.0 pikë), Komuna e Prizrenit (8.3 pikë) dhe Komuna e Deçanit (0.0 pikë).


Radhitja e komunave për nga perfomanca më e mirë në *Transparometrin e Konsultimeve me Publikun*, nga 35 pikët e mundshme, del të jetë Komuna Gjakovës (me 28.7 pikë), Komuna e Prishtinës (me 24.3 pikë), Komuna e Gjilanit (22.7 pikë), Komuna e Graçanicës (17.0 pikë), Komuna e Prizrenit (me 10.0 pikë) dhe Komuna e Deçanit (me nga 3.3 pikë).

TRANSPARENCA NË KOMUNË

TRANSPARENCA NË GJAKOVË

Në Transparometrin Komunal, që matë nivelin themelor të transparencës komunale, Komuna e Gjakovës del të jetë komuna më transparente nga gjashtë komunat e vlerësuara me një nivel të transparencës prej 76.4%. Krahasuar me pesë komunat tjera të pilotuara me këtë indeks, ky nivel i transparencës është nijaft i mirë, megjithatë transparenca nuk është e plotë edhe në këtë komunë në asnjërrën nga katër fushat që matë ky indeks. Niveli transparencës gjithashtu dallon nga një fushë në tjetrën. Përderisa Komuna e Gjakovës del të jetë më transparentja në tri fusha, tek Kuvendi Komunal, Komuna e Gjakovës rangohet e treta pas Gjilanit dhe Deçanit.

TRANSPARENCA NË GJAKOVË (AKR)



Institucioni më transparent i Komunës së Gjakovës është “*Transparenca e Ekzekutivit të Komunës*” në të cilin kjo komunë ka marrë 28.3 pikë. Në këtë shtyllë, Gjakova qëndron mirë me Zyrtarë për informim & Koordinator për qasje në dokumente Zyrtarë, publikim të Raportit Gjashtë-Mujor të Punës, përgjigje për qasje në dokumente zyrtare, raportimi të Kryetares në Kuvend (2 herë në vit), raportim përmes konferencës në media (radio dhe TV), publikim të kontakteve dhe detajeve biografike të Kryetares dhe Drejtoreve, publikimin e Planit Zhvillimor Urban (PZHU). Komuna e Gjakovës ka tre zyrtarë për informim dhe një zyrtar për qasje në dokumente zyrtare dhe ka të publikuar raportin gjashtë-mujor të punës së Kryetares. Komuna ka të shqyrtuara të gjitha kërkosat për qasje në dokumente zyrtare dhe ka kthyer përgjigje në përputhje me asfatin ligjor.

Kryetarja ka bërë raportimin në Kuvend si dhe çdo te premte u përgjigjet pyetjeve të qytetarëve në Radio Gjakova. Po ashtu, në ueb-faqe janë të publikuara detajet biografike të Kryetares, drejtoreve, email-at dhe janë të publikuara edhe planet zhvillimore.

Megjithatë, Komuna e Gjakovës nuk u jep hapësirë në ueb-faqe deklarimeve dhe aktiviteteve të subjekteve opozitore, nuk përditëson ueb-faqen edhe në gjuhën serbe, dhe Kryetarja nuk e ka të zotuar

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

një kohë të caktuar për vizita javore me qytetarë për të dëgjuar brengat e tyre drejtë-për-së-drejti.

Në *Transparencën e Kuvendit Komunal*, Komuna e Gjakovës ka mjaft hapësirë për të qenë më e hapur dhe transparente. Gjakova ka marrë vlerësimin më të ulët krahasuar me shtyllat tjera të vlerësimit të kësaj komune. Në *Kuvendin Komunal* mungon transparenca në këto fusha: “*Qasja në draft-rregulllore të Kuvendit Komunal (përshti planet komunale)*”, “*Organizimi i Kuvendit komunal dhe përgjegjësít e mekanizmave të tij*”, “*Detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit*”, “*Email adresa e anëtarëve të Kuvendit*”. Komuna e Gjakovës nuk ka të publikuara në ueb-faqe draft-rregulloret e Kuvendit Komunal, organizimi i Kuvendit Komunal nuk është i kompletuar dhe mungojnë të dhëna, nuk ka të dhëna biografike për anëtarët e kuvendit dhe nuk i kanë të publikuara email adresat e anëtarëve të Kuvendit.

Transparenca financiare në komunë është mjaft e mirë por komuna ende nuk e ka publike listën e aseteve komunale, shpenzimet dhe buxhetin e detajuar të ndërmarrjeve komunale, planin e prokurimit si dhe raportin e auditimit të vitit paraprak në ueb-faqe. Tek Transparenca e Konsultimeve me Publikun komuna nuk e ka pasur publike draft-buxhetin në ueb-faqe (edhe pse e ka ndarë me kohë kur është kërkuar me kërkesë zyrtare), si dhe ka pengesa në komunikim me bashkësítë lokale përkonsultime publike.

Komuna e Gjakovës del të jetë mjaft transparente edhe në *Konsultime me Publikun* dhe në Transparometr ka 28.7 pikë nga 35.0 të mundshme. Komuna e Gjakovës ka mbajtur katër dëgjime publike për buxhet, ka pasur takime të rregullta me qytetaret në fshatra dhe qytet, ka njoftuar dëgjimet me publikun online dhe offline (në formë elektronike dhe të shkruar) si dhe ka shpërndarë materialin përcjellës për buxhet në këto konsultime buxhetore. Komuna e Gjakovës është mjaft aktive edhe në ndarjen e informatave në rrjete sociale dhe përgjigje të pyetjeve të qytetarëve të interesuar aty.

TRANSPARENCA NË GJILAN


Komuna e Gjilanit del të jetë komuna e dytë më transparente me një nivel të transparencës prej 66.7%. Institucioni më transparent i Komunës së Gjilanit është Kuvendi Komunal në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 29.3 pikë, ndërsa institucion i më pak transparent është Ekzekutivi i Komunës për të cilin Komuna e Gjilanit është vlerësuar me 17.0 pikë. Komuna e Gjilanit nuk ka të publikuar asnjë raport të punës së Kryetarit për gjashtë muaj dhe nuk ka asnjë raport përkonsultime me publikun. Ai ka mbajtur vetëm disa konferenca përmes media. Dëgjimet buxhetore nuk janë të publikuara në ueb-faqe sikurse nuk është publikuar Plani Zhvillimor Urban aktual. Po ashtu në ueb faqe nuk ka informata për asnjë aktivitet të opozitës.

Komuna e Gjilanit ka marrë më së shumti pikë në shtyllën e *Kuvendit Komunal*, pasi që është notuar me pikët më të larta në gjashtë indikatorë të kësaj shtylle. Indikatorët ku kjo komunë ka marrë pikët maksimale janë: “*Takime e seancave të hapura për publik*”, “*Komititetet e Hapura për publik*”, “*Qasja në Procesverbale të Kuvendit*”, “*Qasja në rregulllore (vendimet) të Kuvendit Komunal (përshti planet komunale)*”, “*Mbajtja e Seancave të rregullta (10 në vit)*” dhe “*Organizimi i Kuvendit komunal dhe përgjegjësít e mekanizmave të tij*”. Në Komunën e Gjilanit të gjitha takimet, seancat dhe mbledhjet e komiteteve janë të hapura përmes publikun. Në ueb-faqec është e publikuar rregullorja e vitit 2014, vendimet dhe planet zhvillimore. Poashtu, ne ueb-faqe janë të publikuara: organizimi i Kuvendit Komunal, organogrami dhe përgjegjësítë e tij dhe të gjitha seancat e rregullta janë mbajtur që kanë qenë të parapara.

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

Tek *Transparenca Financiare*, edhe pse Komuna e Gjilanit ka 24.3 nga 35 pikë të mundshme, apo 69.4% transparente, mungon plani i prokurimit, shpenzimet dhe buxhetet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale, raporti i auditimit dhe borxhi publik komunal. Në konsultime publike ka munguar materiali përcjellës për konsultimet të buxhetit të 2015, ndërsa dhc në ueb-faqe nuk është bërë publike drafti i buxhetit për 2015. Një gjë që vlen të përmendet është se gjatë këtyre gjashtë muajve të matjes së indikatorëve, pas takimeve dhe kërkesave të bëra për Komunën e Gjilanit, komuna ka publikuar në ueb-faqe Kornizën Afatmesme Buxhetore.

TRANSPARENCA NË GJILAN (LDK)



TRANSPARENCIA NË PRISHTINË


Komuna e Prishtinës del të jetë komuna e tretë më transparente me një nivel të transparencës prej 55.7%. Shtylla në të cilën Komuna e Prishtinës ka marrë më së shumti pikë në krahasim me shtyllat tjera tështë *Transparenca në Konsultime me Publikun*, ndërsa shtylla në të cilën kjo Komunë ka marrë më së paku pikë tështë *"Transparenca financiare dhe prokurimi publik"*. Tek Transparenca në Kuvend Komunal, Komuna e Prishtinës tështë vlerësuar më së dobëti nga gjitha fushat tjera për shkak se komuna nuk i ka bërë publike transkriptet e seancave të Kuvendit, mungon qasja në drafte të rregulloreve dhe vendimeve para miratimit, transparenca në gjitha rregulloret e aprovuara, si dhe të dhënat biografike dhe kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit Komunal. Kuvendi Komunal i Prishtinës del të jetë më jotransparenti nga 6 komunat e pilotuar në këtë Transparometër dhe merr 17.0 pikë nga gjithsej 35 të mundshme.

Tek *Transparencia Financiare*, Komuna e Prishtinës është mjaft jotransparent me 17.0 pikë për shkak se komuna nuk i ka bërë publike të gjitha ndryshimet buxhetore të Kuvendit Komunal, borxhin publik komunal, raportin e auditimit, planin e prokurimit apo njoftimet për kontrata dhe dhënje të kontratave. Sa i përket ndryshimeve buxhetore të miratuara, komuna e Prishtinës pas kërkesës është arsyetuar se së pari materiali duhet të dërgohet në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe pastaj të ndahet me publik. Ndërsa as pas dy muajve këto ndryshime dhe buxheti nuk ka qenë publik apo i qasshëm në ueb-saqe. Komuna nuk i ka publike as listën e aseteve publike përderisa është arsyetuar se

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

janë duke e bërë evidentimin e listës së pronave komunale ndërsa sa i përket aseteve të saj komuna nuk ka kthyer përgjigje për kërkesën e bërë dhe nuk i ka ato të publikuara në ueb-faqe. Komuna e Prishtinës nuk ka plan të prokurimit konkret të publikuar si dhe nuk ka asnjë njoftim për kontratë dhe për dhënen e kontratave të publikuar në ueb-faqe.

TRANSPARENCA NË PRISHTINË (LVV)



Komuna e Prishtinës ka marrë notën më të lartë për Transparency në Konsultime me Publikun krahasuar me fushat tjera pasi që ka qenë mjaft aktive në informim të qytetarëve me rrjete sociale, ka njoftuar dëgjimet publike për buxhet online dhe offline, ka patur takime të rregullta me qytetaret në fshatra dhe qytet dhe ka mbajt më shumë se 1 konsultim buxhetor për 25,000 banor (gjithsej 9 takime mbi buxhetin e viti 2015). Megjithatë, ka munguar materiali përcjellës për buxhet në këto konsultime buxhetore. Komuna ka mbajtur edhe takime me bashkësítë lokale ne të cilat edhe janë shpërndarë vulat për secilën bashkësi lokale. Ne komunën e Prishtinës po ashtu ka OJQ ne Këshillin Komunal për siguri dhe lista e emrave të anëtarëve është transparente dhe komuna ka mbajtur disa takime dhe konferenca me organizata të shoqërisë civile. Po ashtu faqja e Komunës së Prishtinë vazhdimi isht rifreskohet me informata të reja por fatkeqësisht pjesa e 'lajmeve' ka qenë pjesa e vetme e ueb-faqes që është rifreskuar vazhdimi isht. Tek Konsultimet me Publikun, Komuna e Prishtinës del pak prapa Komunës së Gjakovës vetëm për faktin se nuk ka patur materialin përcjellës të buxhetit në konsultimet me buxhetin për shkak se në të gjithë indikatorët tjerë të kësaj fushë ka qenë njëjtë apo pak më mirë se Komuna e Gjakovës.


Tek Transparency në Zyrë të Kryetarit, Komuna e Prishtinës është relativisht mirë edhe pse mungon transparency kyçë në disa indikatorë si mungesa e kapaciteteve humane në Zyrën për Informim dhe mungesë në përgjigje të kërkesave në qasje të dokumenteve publike. Po ashtu, ueb-faqja zyrtare nuk është e rifreskuar në gjuhën serbe dhe nuk u jep hapësirë deklaratave dhe aktiviteteve të subjekteve opozitare. Megjithatë, në Transparometr Komunal Zyra e Kryetarit të Prishtinës del të jetë 66.5% transparente apo 23.3 pikë nga 35 pikë të mundshme.

TRANSPARENCA NË GRAÇANICË

Në këtë raport të matjes së transparencës në komuna, Graçanica performonë më mirë vetëm se Prizreni dhe Deçani. Graçanica ka një nivel të transparencës prej 46.0%, apo më pak se gjysma. Në këtë komunë nga indikatorët tanë matës, institucioni më transparent del të jetë Kuvendi i Komunës, me 22.0 pikë, përderisa më së paku transparent është Ekzekutivi i Komunës me 9.3 pikë nga gjithsej 35 pikët e mundshme. Në anën tjetër transparenca financiare është notuar me 16.0 pikë, që nënkupton transparencë gjysmake, ndërsa transparenca në konsultim me publikun me 17 pikë që është për një nuancë më mirë sesa shtylla paraprake.

Ekzekutivi i komunës është radhitur si më së paku transparent, për shkak se kanë munguar raporti gjashtë-mujor i punës, raportet nga konsultimet publike me kërkesa të qytetarëve, raportimet e rregullta të Kryetarit para Kuvendit Komunal, përgjigjet në kërkesat për qasje në dokumente nuk kanë qenë në përpunhje me afatet ligjore, nuk ka pasur të publikuara planet zhvillimore të komunës, si dhe nuk ka pasur lajme për subjektet opozitare të komunës në ueb faqe, kjo pjesë i ka takuar vetëm subjektit udhëheqës të komunës.

TRANSPARENCA NË GRAÇANICË (GLS)



Nivel më të mirë të transparencës ka treguar Kuvendi i Komunës, ku publiku ka pasur qasje në rendin e ditës së Kuvendit, të drejtë për qasje direkt në mbledhje, qasje në komitetet e Kuvendit, qasje në procesverbale, irregullore të Kuvendit, dokumentet për shqyrtim në komitete, si dhe Kuvendi ka mbajtur numrin e nevojshëm të mbledhjeve brenda vitit. Megjithatë nuk kanë qenë publike kontaktet dhe detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit si dhe nuk ka pasur qasje në draftet të irregulloreve dhe planeve të Kuvendit para miratimit.

Transparenca financiare nuk është e kënaqshme pasi mungon buxheti i komunës, borxhi publik komunal, raporti i auditimit, plani i prokurimit dhe njoftimet për kontrata dhe dhënie të kontratave. Megjithatë vlen të theksohet se komuna ka të qasshme raportet tre-mujore të shpenzimeve. Pak më mirë qëndron tek transparenca në konsultime publike pasi komuna ka njoftuar mirë dhe ka mbajtur pesë dëgjime publike për buxhet, por nuk ka pasur të qasshëm draftin e buxhetit edhe as materialin


QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

përcjellës në dëgjime publike për buxhet.

TRANSPARENCA NË PRIZREN

Komuna e Prizrenit nuk del të jetë mirë në matje të Transparometrit pasi që niveli i transparencës në këtë 44 indikatorë themelor del vetëm 37.1% transparente. Transparenca financiare është shtylla me vlerësimin më të dobët në këtë komunë. Kështu komuna e Prizrenit ka demonstruar një transparencë shumë të ulët në publikimin e të dhënave nga lidhur me buxhetin e saj si dhe procedurat e prokurimit publik. Sipas të dhënave të mbledhura për këtë hulumtim, komuna nuk ka publikuar raportet tremujore të shpenzimeve, ndryshimet e aprovuara të buxhetit komunal, borxhin publik komunal, buxhetin e ndërmarrjeve komunale, listën e pronave të komunës, planin e prokurimit, raportin e auditimit, të hyrat vetanake të komunës, buxhetin dhe kohëzgjatjen e projekteve kapitale. Komuna ka publikuar me kohë njoftimet për kontratë dhe ato për dhënien e kontratës si dhe ka ofruar qasje në kontratat e lidhura përmes prokurimit publik, përkundër që janë zgjatur afatet e parapara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

TRANSPARENCA NË PRIZREN (PDK)



Ekzekutivi i Komunës së Prizrenit në këtë Transparometër ka dalë të jetë më pak transparent në rapport me Kuvendin Komunal. Ekzekutivi është vlerësuar me 13.7 pikë, deri sa Kuvendi Komunal ka marr 20.0 nga 35 pikë maksimale. Ekzekutivi i komunës është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar raport për gjashtëmëjorin e punës, nuk ka pasur raport për konsultimet e publikut dhe dëgjimet buxhetore, nuk ka pasur të caktuar ditë për vizitat e qytetarëve për Kryetarin e Komunës, nuk ka pasur konferenca të rregullta për media apo adresime të rregullta për publikun, si dhe nuk ka pasur lajme të subjekteve opozitare në ueb faqen e komunës. Po ashtu përgjigja në dokumente zyrtare është bërë duke shkelur afatet ligjore.

Në anën tjeter institucion relativisht më transparent është Kuvendi i Komunës, i cili krahasuar me ekzekutivin e komunës ka publikuar një numër më të madh të dokumenteve zyrtare si dhe ka qenë më i qasshëm për publikun. Kuvendi i Komunës ka pasur mbledhje të hapura për publikun, komitetet e

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

I
D
E
C
A
N
I
T
R
A
N
S
P
A
R
O
M
E
T
R
I
K
O
M
U
N
A
L


hapura, procesverbale të publikuara, qasje në draft rregullore dhe rregullore të Komunës, ka mbajtur numrin e mjaftueshëm ligjor të seancave në vit. Në anën tjeter ka munguar qasja në rendin e ditës së seancave dhe nuk ka pasur të publikuara të dhënët kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

TRANSPARENCA NË DEÇAN

Komuna e Deçanit është komuna me nivelin më të ulët të transparencë nga këto gjatë komuna që janë pilotuar. Komuna e Deçanit del të jetë vetëm 27.4% transparente në 44 indikatorët themelor të këtij Transparometri. Krahasuar me Prizrenin, Deçani është mjaftë keq në nivel dhënie qasje në dokumente, informacione si dhe publikimin përmes ueb faqes.

Komuna e Deçanit është plotësisht jotronsparente tek financaj komunale dhe del të jetë me performancë zero në të gjithë nga 11 indikatorët e transparencës financiare. Asnjë dokument finanziar, raport i shpenzimeve apo të tjetër financiar apo buxhetor nuk është i qasshëm në këtë komunë. Asnjë komunë tjetër nuk ka pasur nivel kaq domethënës të kufizimit të qasjes në dokumentet financiare.

TRANSPARENCA NË DEÇAN (AAK)



Megjithatë, jo gjithçka ka qenë jo transparente. Në fakt, Kuvendi Komunal i kësaj komune ka pasur një performancë më solide, duke siguruar numrin më të madh të dokumenteve dhe është vlerësuar me 24.0 pikë. Kuvendi Komunal i Deçanit si i tillë është një nga institucionet legislative më transparent krahasuar me komunat e tjera. Vetëm Kuvendi Komunal i Gjilanit ka pasur transparencë më të lartë sesa Deçani. Nga 11 indikatorët e vlerësuar, vetëm në dy prej tyre Kuvendi Komunal i Deçanit është vlerësuar me zero pikë. Në 9 indikatorët e tjera, Kuvendi ka marr pikë pozitive.

Ekzekutivi i komunës po ashtu ka një notim relativisht negativ me vetëm 11.0 pikë nga 35 sa është maksimalja. Në shumicën e rasteve mos transparencia është rezultat i mungesës së vullnetit të zyrtarëve komunal për të publikuar të dhëna dhe në asnjë rast nuk bëhet fjalë për mungesë kapacitetesh njerëzore. Komuna ka të angazhuar zyrtarë për informim ashtu sikurse ka caktuar edhe zyrtar për qasje në dokumente zyrtare. Mirëpo përkundër kësaj, këta zyrtarë janë të varur nga drejtoret dhe zyrtarët e tjera politik në punën e tyre. Për t'u publikuar diçka ose jo nuk vendosin zyrtarët për

I
D
E
C
A
N
I
T
R
A
N
S
P
A
R
O
M
E
T
R
I
K
O
M
U
N
A
L

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

informim, mirëpo vendosin krerët e drejtorive përkatëse, apo të paktën kjo është përshtypja jonë nga vizitat në terren dhe intervistat e shumta me zyrtarë komunal të informimit dhe zyrtarë të partive politike.


(KODI I KOMUNA SË PËRQËSHIRUE) (KODI I KOMUNA SË PËRQËSHIRUE)

QASJA NË RRJETE SOCIALE

Bazuar në të dhënat e disponueshme në Kosovë, interneti ka përdorim mjaftë të lartë, duke arritur shifrën 76.62% të popullsisë totale në Kosovë. Duhet thënë se kjo shifër është e përafërt me përdorimin e internetit në vendet e Bashkimit Evropian. Duke parë se përdorimi i internetit kap shifra shumë të mëdha, në fakt pjesën dërrmuese të qytetarëve ë Kosovës, atëherë institucionet mund ta përdorin këtë gjë si një mundësi, për t'i informuar qytetarët mbi punën e institucioneve komunale. Përkundër që shumica e komunave kanë ueb faqe, ato nuk janë edhe aq të vizituara nga qytetarët, përveç në rastet kur të njëjtit kërkojnë ndonjë dokument apo shërbim specifik nga këto ueb faqe. Një numër i komunave me vetë iniciativë kanë filluar që të përdorin Facebook-un si mjet për të informuar qytetarët në lidhje me punët e komunës. Kjo për shkakun se përmes Facebook komuna ka shumë avantazhe ne raport me ueb faqet tradicionale. Sidoqoftë jo të gjitha institucionet komunale kanë një faqe në Facebook dhe ato të cilat tani më kanë hapur, kanë dallime të mëdha në formën e menaxhimit të këtyre faqeve.

Facebook ka disa avantazhe në raport me ueb faqet, pasi që përmes llogarisë në Facebook komunat mund të postojnë lajmet dhe informatat aty ku është audiencia, pa pasur nevojë që ata të kërkojnë për lajmet. Me Facebook, informata u shërbeshet audiencës aty ku ata kalojnë kohën. Facebook për dallim nga ueb faqet aktuale të komunave, lejon interaktivitet në mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të komunës dhe madje është efikas edhe në bllokimin e komenteve ofenduese apo të përsëritshme. Me gjithë avantazhet e Facebook-ut, rrjetet sociale asnjëherë nuk mund zëvendësojnë ueb faqet tradicionale.

KOMUNA NË RRJETE SOCIALE / FACEBOOK



Disa komuna në fakt i kanë dhënë prioritet absolut Facebook-ut, duke e lënë në hije ueb faqen e komunës. Përveç shpërndarjes efektive të lajmës, Facebook nuk mund të zëvendësoj shërbimet e ueb faqeve dhe të dhënavë të cilat mund të merren nga aty. Për shembull të dhënrat për buxhetin, raportet financiare, profilet e përfaqësuesve të komunës, kontaktet etj, është shumë e vështirë të ruhen në Facebook. Madje përmes ueb faqeve disa shërbime të aplikimit online për dokumente, në asnjë

(KODI I KOMUNA SË PËRQËSHIRUE) (KODI I KOMUNA SË PËRQËSHIRUE)

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

mënyrë nuk mund të zëvendësohen nga llogaritë e komunave në Facebook. Ideale për komunat do të ishte që llogaritë në Facebook, t'i shërbejnë ueb faqeve aktuale për t'i shërbbyer lajmet në mënyrë sa më efektive tek audiencia e targetuar, gjë për të cilën Facebook është shumë i përshtatshëm.

Nga monitorimi që u është bërë komunave për këtë periudhë, kemi vërejtur se nga gjashtë (6) komunat e monitoruara, pesë (5) prej tyre tani më kanë hapur llogari në Facebook. Komuna e vetme që ende nuk ka një të tillë është Prizreni. Ndërkoqë që Prishtina, Gjilani, Gjakova, Deçani dhe Graçanica, tani më kanë llogaritë përmes të cilave informojnë qytetarët për shumë ngjarje në kuadër të komunës.

Për t'i krahasuar komunat se sa suksesshëm menaxhojnë me llogaritë e tyre në Facebook, ne kemi matur numrin e pëlqimeve (Likes) që ato kanë, dhe kemi pjesëtar këtë numër me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës përkatëse. Në këto krahasime, kemi parë se Komuna e Graçanicës e cila ka 1,709 pëlqime, ka numrin më të madh krahasuar me popullsinë, pasi që atë e përcjellin mbi 15 % e qytetarëve të kësaj komune. Pas Graçanicës, komuna me numër më të madh të pëlqimeve apo qytetarëve që e ndjekin në Facebook është Gjakova, e cila ka 11,796 pëlqime apo 12.4 % të popullsisë. Komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të pëlqimeve në total 20,816 pëlqime, mirëpo krahasuar me numrin e popullsisë, del se vetëm 10.3 % e qytetarëve e përcjellin komunën përmes Facebook-ut. Komuna e Gjilanit ka po ashtu një numër të madh të qytetarëve që e përcjellin 8,976, apo në përqindje 9.9 % e popullsisë së Gjilanit. Në anën tjetër komuna me performancën më të dobët në Facebook (pas Prizrenit e cila komunë nuk ka fare llogari) është Deçani me 1,433 pëlqime apo 3.5 % të qytetarëve të kësaj komunë që e ndjekin në Facebook këtë institucion.

Shikuar në përgjithësi, katër (4) nga pesë (5) komunat e monitoruara kanë një menaxhim shumë të mirë të llogarive në Facebook, me numër domethënës të qytetarëve të cilët e përcjellin. Mirëpo shqetësues mbetet fakti se Facebook, në disa raste ka ndikuar që komunat të mos i kushtojnë vëmendje ueb faqes zyrtare, siç është rasti me komunën e Prishtinës, e cila në Facebook ka pasur një performancë shumë të mirë, e në anën tjetër ka një ueb faqe e cila krahasuar me komunat e tjera në këtë analizë qëndron shumë dobët për nga numri i informatave që mund të nxirren.

REKOMANDIMET

REFORMIMI I MENAXHIMIT TË UEB-FAQEVE

- MAP të decentralizojë menaxhimin e ueb-faqeve:** MAP duhet të decentralizojë menaxhimin e ueb-faqeve komunale tek komunat në mënyrë që të kenë më shumë liri në organizimin e informatave që ndajnë me qytetarë përmes ueb-faqeve dhe përshtatjen e tyre për popullatën e vetë. Komunat e dinë më së miri se çfarë karakteri i ueb-faqes do duhej ta kishin dhc si ti bënin atraktive për lajme;
- Ueb-faqet të lidhura me rrjete sociale:** Ueb-faqet do duhet të ishin të lidhura me rrjetet sociale Facebook dhe Twitter që lajmet, planet dhe dokumentet kryesore të ngarkuara në ueb-faqe komunale do të ndaheshin edhe përmes rrjeteve sociale ku audiencia është më e madhe dhe mundësia e komentimit dhe përfshirjes qytetare është më e madhe;
- Hapësirë më e madhe punës së Kuvendit Komunal:** Ueb-faqet zyrtare të Komunave për shkak se administrohen nga Zyra e Kryetarit nuk u japid shumë rëndësi dhe vëmendje punës së Kuvendit Komunal. Disa komuna kanë mungesë të informatave për anëtarët e Kuvendit si dhc kontaktet e këtyre përfaqësuesve lokal ndërsa tek pjesa e lajmeve nuk gjinden deklaratat apo aktivitetet e subjekteve të përfaqësuara në Kuvend, sidomos atyre opozitare. Ekziston një link në gjithë platformën e ueb-faqeve që u dedikohet Kuvendeve Komunal dhe kjo rrallë rifreskohet. Po thuaqse e gjithë pjesa tjeter e faqes i dedikohet punëve dhe vendimeve të Ekzekutivit.
- Hapësirë për aktivitetet të opozitës:** Komunat duhet të ndajnë edhe deklarimet e aktivitetet e subjekteve politike opozitare në ueb-faqen e tyre dhe Kryetarët e komunave mos të personalizojnë ueb-faqet për lajme vetëm të tyre apo subjekteve të tyre;

DOKUMENTE LEHTË TË QASSHME ONLINE

- Planet e projekteve kapitale të shpërndahan aktivisht:** Planet e projekteve kapitale duhet të bëhen publike përmes ueb-faqes, rrjeteve sociale dhe lokacioneve publike që të informohen qytetarët para se të kontraktohet projekti. Në këtë mënyrë qytetarët do të janë të informuar për të shprehur mendimet dhe shqetësimet e tyre dhe të janë të dinë se çfarë projekti do të realizohet në lagjet dhe fshatrat e tyre e jo të mbesin në terr informativ deri sa të realizohet projekti komplekt, apo të shfaqen problem dhe pengesa nga qytetarët në mes të projektit;
- Dokumentet publike në ueb-faqe zyrtare:** Komuna duhet ti ketë lehtë të qasshme në ueb-faqe dokumentet kyçë si raportet tre-mujore të shpenzimeve, buxhetin e komunës, kornizën afatmesme të buxhetit, listën e projekteve kapitale dhe listën e aseteve komunale dhe objekteve nën pronësi komunale, në mes tjerash. Nuk mjafton që këto dokumente të janë publike vetëm me kërkësë, pasi që kemi një avancim teknologjik dhe qasjes së përhapur të internetit ku informatat mund të ndahen lehtë dhe shpcjt;
- MAPL të insistojë në publikim të dokumenteve kyçë:** MAPL, si mbikëqyrëse dhe përkrahëse e nivelit lokal, duhet të jetë më aktive në insistimin që komunat të publikojnë raportet tre-mujore të shpenzimeve, listën e projekteve kapitale dhe buxhetet komunale, pasi që janë dokumente me rëndësi të madhe për njoftimin e qytetarëve me punën e institucioneve të tyre lokale;

TRANSPARENCE BUXHETOKE PËR PJESËMARRJE QYTETARE

8. **Fushatë për kërkesat e qytetarëve për draft-buxhet:** Zyra e Kryetarit duhet të ndërmarrë një fushatë informues para se të mbahen dëgjimet publike për buxhet në mënyrë që të ketë njofsim të mirëfilltë për pjesëmarrje qytetare, të njoftohet publiku për irregullat e pjesëmarrjes në dëgjime buxhetore dhe të dihen temat e buxhetit në fokus. Kjo fushatë duhet të filloj nga muaji qershor, kur edhe pritet të diskutohet dhe miratohet Korniza Afat-Mesme e Shpenzimeve (tre-vjeçare) që pastaj përcjellët me buxhetin e vitit të ardhshëm.
9. **Dokumentet të jenë publike në fazën e draftimit:** MAPL duhet të lejojë komunat që të publikojnë aktet komunale edhe si draft e jo vetëm 15 ditë pas miratimit;
10. **Trajnime të zyrtarëve komunale për ndërlidhje me qytetarë:** MAPL duhet të organizojë trajnime për Zyrtarët për Informim për llojin e dokumenteve që duhet të ndahen në ueb-faqe dhe mënyrën se si duhet të ndahen në ueb-faqe, po ashtu edhe për përgjigjen e kërkesave në dokumente publike;

RI-ORGANIZIM INSTITUCIONAL PËR AVANCIM TË TRANSPARENÇËS

11. **Resurse për Kuvendet Komunale:** Kuvendet komunale kanë nevojë për më shumë resurse humane dhe kapacitete teknike për të përpunuuar dhe ndarë informatat e Kuvendit dhe mos të mbeten nën mëshirën e zyrës së Kryetarit;
12. **Mekanizëm komunal për vetëvlerësim:** Komunat duhet të fillojnë të përdorin një mjet të vetëvlerësimit të nivelit të transparencës në institucionin e tyre dhe të vërejnë pikat e dobëta dhe mangësitë e tyre në transparencë që të mund të përmirësohen në qeverisje; Transparometri është një mekanizm i mirë themelor për vetëvlerësim të komunave;
13. **Ndarje të përvojave ndër-komunale për transparencë:** Zyrtarët komunal të komunikojnë më shumë në mes veti për të marrë përvojat e mira pasi që komunat tjera mund të mësojnë nga Komuna e Gjakovës përfunksionimin e Qendrës Informativë me linjë telefonike direkte dhe gratis për qytetarët, të mësojnë nga komuna e Gjilanit për transparencën e Kuvendit Komunal, nga Komuna e Prishtinës përpilimin e Raporteve Gjashtë-Mujore të Punës.

KOMUNA E PRISHTINËS

- **Ngritën Kapacitet në Zyrë për Informim:** Zyra e Informimit ka nevojë për kapacitete humane dhe ndihmë teknike që të mund të përballojë kërkesat e qytetarëve, mediave dhe organizatave për informata publike;
- **Linjë Telefonike Direkte Gratis:** Zyra e Kryetarit të ketë një linjë telefonike direkte tek zyra për informim, mundësishq gratis për qytetarët, që të mund të bëjnë kërkesat e tyre lehtë, jepin propozime dhe të udhëzohen përmes telefonit për qasje në informata publike;
- **Materiali Përcjellës në Dëgjime Publike:** Në konsultimet për buxhet, Komuna e Prishtinës duhet të ofrojë pjesëmariësve një përbledhje të propozim-buxhettit komunal që të shihen qartë planifikimet e projekteve, planifikimet e shpenzimeve dhe shumat e planifikuar për vija buxhetore.
- **Hapësirë Aktivitetave të Opozitës:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë edhe lajme të aktivitetave të opozitës, dhe duhet të gjitha informatat ti ketë të përkthyera edhe në gjuhën tjetër zyrtare, gjuhën serbe.
- **Procesverbalet e Kuvendit:** Kuvendi Komunal duhet të publikojë në ueb-faqe procesverbalet dhe

draft-rregulloret e kuvendit komunal, dhe duhet ta publikojë rendin e ditës në kolonën përkatëse e jo vetëm në rubrikën e laimeve:

- **Detajet biografike dhe kontaktet e Anëtarëve të Kuvendit:** Kuvendi Komunal duhet të bëjë publike detajet biografike dhe të dhënrat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit;
 - **Qasje e Planifikimeve Buxhetore në Ueb:** Transparency financiare në Komunën e Prishtinës duhet të rritet ndjeshëm për shkak se menaxhon një buxhet prej më shumë se 63.4 milion € dhe 27.5 milion € për investime kapitale. Zyra e Kryetarit duhet ti bëjë lehtë të qasshme në ueb-faqe, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm dhe listën e projekteve kapitale; Po ashtu duhet të jenë transparente edhe plani i prokurimit dhe njoftimet për kontrata si dhe njoftimet për dhënien e kontratave;
 - **Buxhetet e Ndërmarrjeve nën Mbikëqyrje:** Zyra e Kryetarit duhet të bëjë publike të dhënrat e buxhetit të ndërmarrjeve komunale dhe rajonale dhe raporteve të shpenzimeve, në mënyrë që qytetarët të mos i kërkojnë ato nga ndërmarrjet publike;

KOMUNA E PRIZRENIT

- **Raportojë Aktivitetin Gjashtë-Mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë raportet gjatë-mujor të punës së kryetarit dhe Kryetari duhet të raportojë para anëtarëve të Kuvendit për situatën socio-ekonomike dhe për buxhet, jo përmes drejtoreve komunal;
 - **Linjë Telefonike Direkte Gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën, dhe të hap një faqe zyrtare të komunës ne Facebook në mënyre që qytetarët ta kenë sa më të lehtë informimin;
 - **Takime Javore me Qytetarë:** Kryetari duhet të caktojë një ditë në javë në të cilën ai ndan kohën për shqetësimet e qytetarëve si dhe duhet të marrë pjesë në konferencë për media për ti informuar qytetarët se me çka është duke u marrë komuna e tyre;
 - **Transparenca e Shpenzimeve Komunale:** Zyra e Kryetarit duhet të publikoj në ueb-faqe borxhin publik komunal, raportet e shpenzimeve, të hyrat vetanake të komunës, planin e prokurimit, dhe planin, buxhctin dhe kohëzgjatjen e Projekteve kapitale;
 - **Kuvendi Komunal të Hapet për Publik:** Kuvendi Komunal duhet të publikojë në ueb-faqe rendin e ditës së seancave, të gjitha procesverbalet e Kuvendit si dhe të publikojë draft-rregulloret e Kuvendit Komunal për çdo vit. Organizimi i Kuvendit Komunal dhe përgjegjësitë e mekanizmave të tij duhet të jenë të publikuara në mënyrë të detajuar dhe duhet të përfshihet organogrami i cili ende mungon, po ashtu duhet të publikohen detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit dhe e-mail adresat e tyre;
 - **Qasje në Rrjete Sociale:** Komuna e Prizrenit duhet të aktivizojë një llogari zyrtare në Facebook dhe ta promovojë atë duke shpërndarë informata dhe dokumente me rëndësi për qytetarë;
 - **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Kuvendi Komunal duhet të përpilojë një rregulllore për bashkësítë lokale dhe një rregull të pjesëmarrjes së qytetarëve, dhe
 - **Zbatojë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike:** Zyra për Informim duhet të zbatojë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike si e specifikon Neni 5.2 dhe 5.3, pra duke i drejtuar vetë kërkesat pa patur nevojë që të kërkoj nga qytetarin tek njësitet tjera të komunës. Zyrtari për dokumente duhet të përgatitur dokumentet e kërkuar për qytetarët dhe dërguar kërkuesit direkt dhe mos të shërbej vetëm si orientim për tek drejtorië dhe zyrat ku dokumentet gjinden pasi që e komplikon qasjen në dokumente zyrtare, e tej-zgjatë kohën e qasjes në dokumente.

KOMUNA E GJILANIT

- **Raportoj Aktivitetin Gjashtë-Mujor:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe reportin gjashtë-mujor të punës, raportet për konsultime me publikun dhe dëgjimet buxhetore, planet zhvillimore të Komunës, lajme të subjekteve politike opozitare në kuvend, dhe informata transparente edhe në gjuhët tjera zyrtare.
- **Raporti i Rregullt në Media:** Kryetari i Komunës duhet të informojë qytetarët më rregullisht përmes mediave për gjendjen e komunës dhë punët komunale si dhe duhet të mbajë të paktën gjashtë dëgjime buxhetore, dhe gjatë këtyre dëgjimeve të shpërndajë material përcjellës të buxhetit për qytetarë;
- **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Komuna duhet të bëjë konsolidimin dhe konsultimin e të gjitha bashkësive lokale të cilat janë në proces që informatat e komunës të ndahanë në mënyrë më efektive në komunitete të komunës dhe të kanalizohen më mirë kërkesat e qytetarëve nga e gjithë komuna;
- **Buxhetet e Ndërmarrjeve nën Mbikëqyrje:** Zyra e Kryetarit duhet të publikojë në ueb-faqe Borxhin Publik Komunal, Raportin e Auditimit, Buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale dhe raportet tre-mujore e shpenzimeve, dhe duhet te publikojë Planin e Prokurimit;
- **Rendi i Ditës Lehtë i Qasshëm në Ueb:** Kuvendi Komunal të publikojë rendin e ditës në kolonën përkatëse e jo vetëm në rubrikën e lajmeve.

KOMUNA E GJAKOVËS

- **Qasje në Draft të Buxhetit:** Zyra e Kryetares duhet të publikojë në ueb-faqe draftin e buxhetit të viti të ardhshëm, listën e aseteve komunale, shpenzimet dhe buxhetin e detajuara të ndërmarrjeve komunale, planin e prokurimit si dhe raportin e auditimit të viti paraprak në ueb-faqe; Komuna pasi që të bëhen kërkesat zyrtare duhet të jetë e gatshme të dërgojë shpenzimet dhe buxhetet e ndërmarrjeve komunale, rajonale;
- **Detajet biografike dhe kontaktet e Anëtarëve të Kuvendit:** Kuvendi Komunal duhet të bëjë publike detajet biografike dhe të dhënat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit si dhe organogramin e institucioneve lokale që qytetarët e interesuar të mund të orientohen më lehtë;
- **Rendi i Ditës Lehtë i Qasshëm në Ueb:** Kuvendi Komunal duhet ta publikojë rendin e ditës për seancë ne ueb-faqe tek rubrika e tyre adekuate, dhe të publikojë në ueb-faqe draft-rregulloret e Kuvendit Komunal duke përfshirë edhe planet komunale;
- **Takime Javore me Qytetarë:** Kryetarja e Komunës duhet ta rezervojë një ditë në javë për vizita me qytetarë që kanë kërkesa dhc propozime për komunën e tyre;
- **Hapësirë Aktivitetave të Opozitës Komuna** duhet të publikojë edhe lajme për aktivitetet e opozitës dhe duhet të përkthehen të gjitha informatat edhe në gjuhët tjera zyrtare.

KOMUNA E DEÇANIT

- **Transparenca e Shpenzimeve Komunale:** Transparency financiare duhet të rritet ndejshëm pasi që Zyra e Kryetarit duhet ta publikojë në ueb-faqe raportet e shpenzimeve, të hyrat vetanake të komunës, planin, buxhetin dhe kohëzgjatjen e Projekteve kapitale, planin e prokurimit si dhe njoftimet për kontratë dhe dhënicen e kontratave;
- **Konsultohet për Buxhetin Komunal:** Kuvendi Komunal duhet të mbajë gjashtë dëgjime

buxhetore dhe të gjitha këto dëgjime duhet të jenë të hapura për qytetarë, po ashtu në këto dëgjime qytetarëve duhet të u shpërndahet materiali përcjellës. Pas dëgjimeve komuna duhet të publikojë draft buxhetin apo rishikimin e buxhetit.

- **Raportim Para Përfaqësuesve Lokal:** Kryetari i Komunës duhet të raportoj para kuvendit dy herë në vit ashtu siç edhe parashihet me ligj dhe duhet të mbajë konferencë për media
 - **Raportojë Aktivitetin Gjashtë-Mujor** Kryetari duhet të publikojë reportin gashtë-mujor të punës së Kryetarit, dhe të gjitha informatat në ueb-faqe duhet ti ketë të përkthyera edhe në gjuhët tjera zyrtare përveç shqipes;
 - **Qasje më Efektive në Rrjetet Sociale:** Zyra për Informim të jetë më aktive në ndarjen e informatave në llogarinë zyrtare të Komunës në Facebook, ta promovojojë atë tek qytetarët e Deçanit dhe ta lidh atë me ueb-faqen komunale;
 - **Bashkëpunim me Bashkësi Lokale për Transparencë:** Kuvendi Komunal duhet të bëje konsolidimin dhe konsultimin c bashkësive lokale si dhe duhet të mbajë takime me organizatat e shoqërisë civile
 - **Kuvendi Komunal më i Qasshëm në Ueb:** Kuvendi Komunal duhet të publikojë në ueb-faqe rendin e ditës së seancave, procesverbalet e Kuvendit dhe draft-rregulloret e Kuvendit Komunal në mënyrë që të jetë sa më transparentë.

KOMUNA E GRANCANICËS

- **Raportoj Aktivitetin Gjashtë-Mujor:** Kryetari i Komunës duhet të publikojë në ueb-faqe reportin gjatë-mujor të punës komunale, raportet për konsultime me publikun dhe dëgjimet buxhetore, planet zhvillimore të komunës; po ashtu, Zyra për Informim duhet të publikojnë ditën se kur kryetari pret qytetarët për vizita, dhe të gjitha të dhënat biografike të Kryetarit dhe Drejtoreve.
 - **Transparencë e Shpenzimeve Komunale:** Komuna në rast të kërkesës duhet të dërgojë raportet tre-mujore të shpenzimeve, raportet për ndërmarrje komunale, rajonale dhe si dhe listat e pronave në pronësi të komunës si dhe ato të marra me qira për Komunën;
 - **Linjë Telefonike Direkte Gratis:** Komuna duhet të ketë një linjë direkte për brengat e qytetarëve, dhe të mbajë takime me organizata të shoqërive civile.
 - **Raportim para Përfaqësuesve Lokal:** Kryetari duhet të bëje raportimin për gjendjen socio-ekonomike të komunës çdo gjashtë muaj para në Kuvend Komunal ashtu siç parashihet edhe me ligj.
 - **Materiali Përcjellës në Dëgjime Publike:** Komuna duhet që gjatë dëgjimeve buxhetore të shpërndajë materiale përcjellëse, të publikojë draft-buxhetin e komunës për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, dhe të përpilojë një rregull për pjesëmarrjen e qytetarëve.
 - **Transparencë në Prokurim:** Komuna duhet ta bëjë publike në ueb-faqe borxhin publik komunal, raportin e auditimit, planin e prokurimit dhe njoftimet për kontratë dhe për dhënien e kontratave.
 - **Kuvendi Komunal më i Qasshëm në Ueb:** Kuvendi Komunal duhet të publikojë rendin e ditës së seancave në ueb-faqe në kolonën adekuatë në mënyrë që të xhindet më lehtë, të publikojë draft-rregulloret e Kuvendit Komunal, të gjitha detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit si dhe email adresat e tyre.

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

(D) (D)

ANEKSET, INDIKATORËT DHE KOMENTET

ANEKS 1: INDIKATORËT DHE PESHA E TYRE

#	KUVENDI KOMUNAL	PESHA	#	FINANCAT	PESHA
1	Mbajtja e seancës mujore	5	1	Raportet e shpenzimeve tre-mujore	5
2	Qasja në rregulloret & vendimet	5	2	Publikimi i kontratave	5
3	Qasja në Procesverbale	4	3	Plani, buxheti dhe projektet kapitale	4
4	Detajet biografike të Asambleistëve	4	4	Të hyrat vetanake	4
5	Email adresat e anëtarëve	3	5	Ndryshimet në buxhet nga legjislativi	3
6	Seancat e hapura për publik	3	6	Borxhi publik komunal	3
7	Qasja në draftet e rregulloret e planeve	3	7	Plani i prokurimit	3
8	Qasja në dokumente të Komiteteve	3	8	Njoftimet për kontrata	3
9	Qasja në Rend të Ditës	2	9	Buxhetet e ndërmarrjeve komunale	2
10	Komititet e hapura për publik	2	10	Lista e pronave komunale	2
11	Organizimi i Kuvendit dhe përgjegjësítë	1	11	Raporti i auditimit	1
PIKË GJITHSEJ		35	PIKË GJITHSEJ		35

#	ZYRA E KRYETAR/IT/ES	PESHA	#	KONSULTIMET PUBLIKE	PESHA
1	Raporti Gjashtë-Mujor i Punës	5	1	Linjë direkte pa pagesë për qytetarët	5
2	Niveli i përgjegjes së kërkesave zyrtare	4	2	Rifreskimi i faqes së Facebook	5
3	Raportimi i Kryetar/it/es në Kuvend	4	3	Takimet publike të rregullta	4
4	Planet Zhvillimore të Komunes (PZHU)	4	4	Dëgjimet publike për Buxhet (propc./banorë)	3
5	Zyrtarë për informim & Koordinatori	3	5	Draft-Buxheti i Komunës në konsultime	3
6	Raport për konsultimet me publikun	3	6	Njoftimi (on&offline) për dëgjimet publike	3
7	Raportimi i rregullt në media	3	7	Materiali përcjellës për konsultimet	3
8	Detajet biografike - Kryetarit & Drejtoreve	4	8	Rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve	3
9	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare	3	9	Takimet me organizata të shoqerisë civile	3
10	Lajme të subjekteve politike opozitare	2	10	Konsolidimi & konsultimi i bashkësive lokale	2
11	Vizitat javore	1	11	OJG në Keshillin e Sigurisë në Bashkësi	1
PIKË GJITHSEJ		35	PIKË GJITHSEJ		35

(D) (D)

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

ANEKS 2: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (1)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KUVEND KOMUNAL	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRÇANICË	DEÇAN
Ueb-Faqe	Qasja në rregulloret, vendimet dhe planet	2	3	3	3	2	3
Fizikisht	Mbajtja e Seancave të rregullta (10 në vit)	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Qasja në Procesverbale	0	1	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit	0	1	0	2	0	2
Ueb-Faqe	Email adresa e anëtarëve të Kuvendit	0	0	0	2	0	3
Fizikisht	Seancat e hapura për publik	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Qasja në draftet e rregulloreve dhe planeve	0	1	0	2	0	0
Fizikisht	Qasja në dokumente në shqyrtim te Komiteteve	3	1	3	2	3	2
Ueb-Faqe	Qasja në Rendit të Ditës	1	0	1	1	1	1
Fizikisht	Komitelet e hapura për publik	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Organizmizimi i Kuvendit dhe përgjegjësít	0	1	1	3	3	2

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË EKZEKUTIVIN E KOMUNËS	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRÇANICË	DECAN
Ueb-Faqe	Raporti Gjashtë-Mujor i Punës	2	3	3	3	2	3
Kërkesë Zyrt.	Niveli i përgjigjes për qasje në dokumente zyrtare	3	3	3	3	3	3
Fizikisht	Raportimi i Kryetarit/es në Kuvend	0	1	3	3	3	0
Ueb-Faqe	Planet Zhvillimore të Komunës (PZHU)	0	1	0	2	0	2
Fizikisht	Zyrtarë për informim & Koordinatori për dokumente	0	0	0	2	0	3
Kërkesë Zyrt. Ueb-faqe	Raport për konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore	3	3	3	3	3	3
Ueb-Faqe	Raportimi i rregullt në media	0	1	0	2	0	0
Ueb-Faqe	Detajet biografike të Kryetarit/es dhe Drejtoreve	3	1	3	2	3	2
Ueb-Faqe	Ueb-faqja në gjuhët tjera zyrtare (gjuhë në përdorim)	1	0	1	1	1	1
Ueb-Faqe	Lajme të subjekteve politike opozitarë në Kuvend	3	3	3	3	3	3
Fizikisht	Vizitat javore Kryetarit	0	1	1	3	3	2

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

ANEKS 3: TRANSPAROMETRI KOMUNAL (2)

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA FINANCIARE	PRISHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRACANICË	DECAN
Ueb-Faqe	Raportet tre-mujore të shpenzimeve (detajuara)	2	0	3	3	2	0
Kërkesë Zyrt.	Publikimi i kontratave	3	2	3	2	2	0
Ueb-Faqe	Plani, buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve kapitale	2	0	3	3	2	0
Ueb-Faqe	Të hyrat veta nake të komunës	3	0	3	3	3	0
Kërkesë Zyrt.	Ndryshimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi	0	0	3	3	1	0
Ueb-Faqe	Borxhi publik komunal	0	0	3	0	0	0
Ueb-Faqe	Plani i prokurimi	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	Njoftimet për kontratë dhe për dhenien e kontratave	0	3	3	3	0	0
Kërkesë Zyrt.	Buxhetet dhe shpenzimet e ndërmarrjeve komunale dhe rajonale	0	0	0	0	0	0
Kërkesë Zyrt.	Lista e pronave (zyrat, lokalet, etj) në pronësi komunale dhe të hyrat e detajuara	0	3	0	3	0	0
Ueb-Faqe	Raporti i auditimit	1	0	0	0	0	0

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN	PRISEHTINË	PRIZREN	GJAKOVË	GJILAN	GRACANICË	DECAN
Fizikisht	Linjë direkte papgesë për brengat e qytetarëve	2	0	3	3	0	0
Ueb-Faqe	Rifreskimi i faqës së Facebookut	3	0	3	3	3	2
Fizikisht	Takimet publike të rregullta	3	1	3	3	3	0
Fizikisht Ueb	Dëgjimet publike për buxhet (propc./banorë)	3	2	2	1	2	0
Ueb-Faqe	Draft-Buxheti i Komunës (ose drafti i rishikimit)	0	1	2	1	0	0
Fizikisht Ueb	Njoftimi (on dhe offline) për takimet publike	3	3	3	3	3	0
Fizikisht	Materiali përcjellës në dëgjime buxetore	0	0	3	0	0	0
Fizikisht	Rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve	0	0	0	0	0	0
Fizikisht	Takimet me organizata të shoqërisë civile	3	1	3	2	0	0
Fizikisht	Konsolidimi dhe konsultimi i bashkësive lokale	3	1	1	1	3	0
Fizikisht	OJQ në Këshillin Komunal për Siguri	3	3	3	3	3	0

QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

|||||

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

ISBN

|||||



Me përkrahjen financiare të:

